


Regjistrimi në shkollë -

Informacione për prindërit , fëmijët e të cilëve e mësojnë gjuhën Gjermane si gjuhë të dytë.



Prindër të dashur,

Nëse fëmiju juaj mbush gjashtë vjet deri me 30.06.2026, apo më mirë të themi, nëse fëmiju juaj është lindur para 01.07.2020, do të thotë se është i gatshëm për shkollim, pra në vitin e ardhshëm shkollor 2026/27 (nga Shtatori 2026) **është i obligueshëm të shkoj në Shkollë**. Fëmiju juaj pra në raste normale nga Shtatori i vitit 2026 duhet të shkoj në Shkollë.

Fëmijët të cilët janë të lindur në kohën **prej 01.Korrikut deri me 30.Shtator 2020 mund të jenë të detyrueshëm për shkollim, nëse Prindërit apo Kujdestarët nuk e shtyjnë regjistrimin për vitin e ardhshëm shkollor.**

Nëse Prindërit apo Kujdestarët dëshirojnë të shtyjnë **regjistrimin** për vitin e ardhshëm shkollor 2027/2028, atëherë duhet të lajmërohen me shkrim më së voni deri me **10.Prill 2026.Sidoqoftë këta fëmijë kalojnë në procedurën e lajmërimit dhe regjistrimit në shkollë, ashtu si të gjithë fëmijët e tjerë.Shkolla i këshillon Prindërit dhe do ju jep propozime.** Pastaj Prindërit mund të vendosin se a duan të regjistrojnë fëmijët e tyre në vitin shkollor që vijon apo në vitin e ardhshëm.Nëse Prindërit nuk lajmërohen me shkrim deri me 10.Prill atëherë fëmiju juaj do të jetë i detyrueshëm të shkoj në shkollë në vitin 2026/2027.

Prindërit që i kanë fëmijët në moshë shkolle, do të pranojnë një letër nga shkolla adekuate. Në këtë pikëpamje ju do të ftoheni për regjistrime në Shkollë , në një ditë e cila është caktuar në Mars të vitit 2026. Prindërit duhet të vijnë në shkollë së bashku me fëmijën e tyre i cili do të shkojë në Shkollë.

Ky termin është shumë me rëndësi! Ju lutem shkoni **për çdo rast** edhe nëse nuk jeni të sigurtë se a është fëmiju juaj i gatshëm për shkollim. Për shkak se ky është një obligim shkollorë, pra edhe termini për regjistrimin shkollorë është i **obligueshëm**. Nëse jeni të nxanun ju lutem bisedoni dhe informoni Shkollën.

Gjithashtu, që të reregjistrohen janë të gjithë fëmijët regjistrimi i të cilëve u shty vitin e kaluar ose që u shty nga ndjekja e shkollës fillore vitin e kaluar.

Tërheqja nga shkollimi

Nëse keni dyshim se a është fëmiju juaj i gatshëm për shkollim apo jo, keni mundësi të konsultimit për ta regjistruar fëmijën tuaj një vit më vonë në Shkollë.

Me rëndësi është mendimi i qerdhes. Edukatorët i njohin fëmijët dhe mund të konkludojnë, se çka kërkohet në Shkollë. Nëse nuk jeni të sigurtë, ju mundeni të kontaktoni edhe në zyrën këshillimore ku do të bëhet një test me fëmijën tuaj. Gjithashtu edhe qendra speciale për nxitje ka një zyre këshilluese.

Mirëpo edhe nëse ju jeni të bindur se fëmiju juaj duhet të pres edhe një vit, ju lutem paraqituni në këtë termin dhe ndëgjoni se çfarë do të ju informojnë mësuesit lidhur me këtë temë!

Aty do të ketë njerëz me përvojë shumë të gjat me fëmijë të kësaj moshe, ku mund të ju keshillojnë. Vendosja për tërheqje nga viti shkollor së fundi i takon shkollës duke i marrë parasysh perceptimet egzistuese .

Çka do të ndodhë në regjistrimin shkollorë?

Së pari do të shënohen disa informacione: Emri Mbiemri dhe Adresa, mirëpo edhe gjuha të cilën e flisni në shtëpi, etj.

Mirëpo me rëndësi të posaqme është, që mësuesi të ketë një pasqyrë për fëmijun tuaj. Ata do të mundohen ta vlerësojnë se a është fëmiju juaj i gatshëm për shkollim, dhe a mundet ti përcjell ligjëratat, mirëpo edhe atë se sa e ka mësuar fëmiju juaj gjuhën Gjermane.

Mirëpo se si është kjo e strukturuar mvaret nga organizimi i shkollës, pasi që çdo shkollë ka organizim tjetër, mund të ndodh në një bisedë të shkurtër me mësuesen, apo një „orë provuese“ me një grup fëmijësh.

Nganjëherë do të ftohen Prindërit edhe në një termin të ri, për shkak se mësuesit dëshirojnë ti njoftojnë fëmijët tuaj më mirë. Për këtë nuk duhet të keni frikë!

Udhëzime të vlefshme për Shkollën na sjellë edhe letra të cilën e keni plotësuar së bashku me Edukatoren në qerdhe. Ju lutemi ta sjellni me vete gjatë regjistrimit në Shkollë !

Çka vijon pas regjistrimit në Shkollë?

Prindërit që me fëmijët e tyre në shtëpi flasin një gjuhë tjetër, merakosen se a e ka përvetësuar fëmiju i tyre mjaft gjuhën Gjermane. Që në këtë rast të ndihmojnë, në qerdhe egzistojnë disa vite „para kurse Gjermane“ që me siguri fëmiju juaj e ka vizitu.

Me rëndësi: Mosnjohja apo mangësia e gjuhës nuk jan shkas që të mos pranohet në shkollë. Përrjashtimi është nëse fëmiju juaj nuk e ka vizituar qerdhën apo këtë „parakursin Gjerman“, prandaj fëmiju juaj është i detyrueshëm që të vizitoj qerdhen dhe të merr pjesë në këtë parakursin Gjerman. Mirëpo ky është një rast shumë i rrallë.

Mësuesit mundohen të ju ndihmojnë të githë fëmijëve në përvetsimin e gjuhës Gjermane, e posaqërisht atyre që gjuhën Gjermane nuk e kan gjuhë amtare. Këtu kem të bëjmë me mundësi të ndryshme:

- **“DeutschPLUS-Kurse“:** Kjo do të thot, që fëmiju juaj viziton klasën normale, mirëpo si shtojcë viziton edhe një kurs të gjuhës Gjermane (me një apo më shumë orë shtesë në javë).

- **„DeutschPLUS-Differenzierung“:** Kjo është një klasë e posaqme për fëmijët jo gjerman, në lëndët kryesore (Gjermanisht, Matematikë, dhe lëndë elementare) të ken një ndihmesë të posaqme, dhe lëndët tjera ti vizitojnë dhe mësojnë me fëmijët tjerë së bashku ne klasën e tyre.

- **„Deutschklasse“:** Kjo vlen për ata nxënës që nuk e flasin fare gjuhën Gjermane, të cilët p. sh. nuk gjenden kohë të gjatë në Gjermani.

Kjo klasë e veçantë nuk mund të ngrihet në qdo shkollë, kështu që fëmija juaj mund të caktohet në një shkollë tjetër fillore.

Për të gjithë fëmijët që ngecin në zhvillim, apo kanë aftësi të kufizuara, munden që të vizitojnë shkollën speciale për nxitje, në bazë të diagnozës që e posedojnë.

Në këtë klasë fëmijët mësojnë me një ritëm më të ngadalshëm se në shkollimin e rregullt, kështu që mësimi i rregullt dyvjeçar këtu mësohet për tri vite.

Shumë fëmijë që posedojnë një diagnosë, që të vizitojnë klasën speciale për nxitje, përcjellen me një start të suksesshëm. Një kalim nga kjo shkollë në shkollën e rregullt mund të posedoj me dëshirën e **Prindërve** në çdo kohë .Në raste normale vizita e kësaj **shkolle speciale për nxitje** mund të posedoj vetëm me pëlqimin e Prindërve. Nëse nga qendra Pedagogjike ndihmëse ka ndonjë dyshim atëherë drejtpërsëdrejti mund ta lajmëroni në qendrën ndihmëse.

Në qoftë se dëshironi që fëmiju juaj të vizitoj shkollën adekuate, është një përparësi e madhe nëse lejoni që fëmiju juaj t'ju nënshtrohet testeve dhe të pranoni këshilla të mëtutjeshme. Këtu është e përfshirë një „Qendër këshillimore” Në Zyrën e Arsimit Shtetëror (Donaustaufer Straße 70).

Nëse keni pyetje për regjistrimin e fëmiut tuaj në shkollë, mundeni në çdo kohë të drejtoheni te ne, apo në çdo zyrë tjetër këshillimore në Regensburg. Këshillimi është pa pagesë dhe konfidencial (i besueshëm) dhe nëse dëshironi do të keni një Përkthyes gjatë bisedimeve. Numri ynë i telefonit është 0941/507-2762.

Ne Ju dëshirojmë juve dhe fëmijëve tuaj çdo të mirë dhe një rrugë të suksesshme në shkollë!